

Mynih - Bazel tour (O-ETR-780)



MYNIH- BAZEL

Shteti: Gjermani

Kategoria Ofertes: Mynih - Basel, 27Nentor, 5Dite 399€

Emri Hotelit: Standart hotel - 3 Yje

Tipi Ofertës: Mëngjes

Kohezgjatja:

Nisja:

Transporti: Avion

Cmimi:

Dita e Parë: Fluturimi Direkt Tiranë - Mynih. Nisja më 10.00 - Mbërritje më 12.00. Nisja për në qytezën Hohenschwangau. Udhëtimi zgjat rreth 1.5 orë. Mbërritje në Hohenschwangau, ku vizitohet Keshtjella e Bukuroshes së Fjetur, Neuschwanstein. Vazhdon udhëtimi për në Bazel. Udhëtimi zgjat 3,5 orë pa ndalesa. Ndalesa të shkurtra gjatë udhëtimit. Shëtitje panoramike në qytet, kalohet mbi urën Wettsteinbrücke mbi lumin Ren që përshkon qytetin mes për mes. Ndalesë afër Muzeut të Artit në qytet nga ku fillon vizita, e cila bëhet në këmbë për të vizituar qytetin e vjetër mesjetar të Bazelit, Katedralen e shek. 11-të, e cila quhet Münster dhe sheshin qendror Marktplatz ku gjendet edhe bashkia impresionuese e qytetit. Sistemimi dhe Fjetje në hotel.

Dita e Dytë: Mëngjesi në hotel. Në orën 08:00 do të nisemi për në Zyrih. Udhëtimi zgjat 2 orë. Mbërritja në Zyrih. Vizitë e qytetit nga Quaibrücke duke vizituar fillimisht sheshin Seschelaütenplatz ku gjendet godina e mrekullueshme e Operas së qytetit. Shëtitje në këmbë duke vizituar Rathaus, Grossmünster dhe Fraumünster dhe Peterkirche. Vazhdohet tek distrikti universitar, Lindenhof dhe në Bulevardin më të njohur të qytetit, në rrugën tregtare Bahnhofstasse. Nisja për në Mynih. Udhëtimi zgjat rreth 3 orë. Mbërritje në Mynih. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Tretë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Monumentet kryesore të Mynihut, si: Sheshi Marienplatz, Bashkia e Qytetit, Viktualienmarkt, Kisha Frauenkirche, Shtëpia e famshme e Birrës Hofbrauhaus, Teatri Kombëtar, Pallati Mbretëror, më i madhi në Gjermani. Fjetje në Hotel.

Dita e Katërt: Mëngjesi në Hotel. Vizitë në Sheshin Olimpik, kulla Olimpikë 210 metra e lartë. Vazhdon vizita në Selinë e BMW dhe Muzeun përkatës. Më pas shkohet në rezidencën verore të Mbretërvë Bavarezë, Pallati i Nymphenburg. Pasdite, vizitë në muzeumin e Alte Pinakothekë. Fjetje në Hotel.

Dita e Pestë: Transfertë për në aeroportin e Mynihut. Fluturimi direkt Mynih - Tiranë. Nisja më 07.25 - Mbërritje më 09.20.

Nisja më 27 Nëntor

Në pagesë përfshihet:

1. Udhëtimi vajtje-ardhje me avion,
2. Transfertat dhe shëtitjet me autobus,
3. Akomodim në hotel me 3 yje,
4. Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit,
5. Shoqërues shqiptar gjatë qëndrimit jashtë Shqipërisë.
6. Lejohet të merret me vete në avion vetëm një bagazh me përmasa deri në 40 x 30 x 20 cm. (Kujdes - Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

Në pagesë nuk janë përfshirë:

- Gjithshka që nuk është përmendur në këtë program.



Agjensia Turistike eTour.al

Tel: +355 67 20 300 10 || Tel:
Email: info@etour.al || Website: www.eTour.al

- Hyrjet në monumente dhe muzeume.

eTour.al